

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 430 Prot.

Tiranë, më 19 .04 2016

VENDIM Nr. 24, datë 13.04.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë"(i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.4 të datës 13.04.2016, pasi shqyrtoi Raportin e vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të projektit "**HEC LUMZI dhe HEC TUÇI, Bashkia Fushë Arrëz, rrethi Pukë**"- "**M.C. INERTE LUMZI**" SH.P.K., realizuar nga shoqëri i licencuar në arkeologji "AD-STAR" SH.P.K." dhe informacionin e ardhur nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe nga Ministria e Mjedisit,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të projektit "**HEC LUMZI dhe HEC TUÇI, Bashkia Fushë Arrëz, rrethi Pukë**"- "**M.C. INERTE LUMZI**" SH.P.K., realizuar nga shoqëri i licencuar në arkeologji "AD-STAR" SH.P.K." dhe informacionin e ardhur nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe nga Ministria e Mjedisit.
2. Gjatë zbatimit të punimeve të realizohet mbikqyrja arkeologjike nga DRKK Shkodër, e cila duhet të depozitohet pranë Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik dokumentacionin për të, duke lidhur më parë aktmarrëveshje tre palëshe me ASHA dhe investitorin, sipas vendimit të KKA Nr. 102, datë 1.09.2015.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO